



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 71, datë 29.04.2025**

**PËR**  
**MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUTIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT**  
**“INSIG JETË” SH.A.**

Në zbatim të pikës 22, të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe Rregullores nr. 1, datë 25.01.2016 “Për procedurat dhe mënyrën e depozitimit të informacionit dhe dokumentacionit në lidhje me burimin e kapitalit për aksionarët e shoqërisë së sigurimit”, të Rregullores nr.138, datë 21.12.2015 “Për miratimin ose refuzimin e ndryshimeve thelbësore të statutit të shoqërisë së sigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

**1. Miratimin e ndryshimit të nenit 7 të statutit të shoqërisë së sigurimit “Insig Jetë” sh.a., si rezultat i rritjes së kapitalit, si më poshtë:**

“Neni 7 Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë është 600,000,000 (gjashtëqind milion) lekë, (pas shtim kapitali themeltar cash, në mjete monetare me 10,000,000 (dhjetë milion) lekë si më poshtë:

| Nr. | Emërtimi      | Ishte             |           |               | Bëhet             |           |               |
|-----|---------------|-------------------|-----------|---------------|-------------------|-----------|---------------|
|     |               | Numri i aksioneve | Përqindja | Vlera në lekë | Numri i aksioneve | Përqindja | Vlera në lekë |
| 1.  | Eurosig sh.a. | 616,00            | 100 %     | 590,000,000   | 626,44067         | 100 %     | 600,000,000   |

Vlera nominale për aksion 957.792,21 lekë.”

**2. Ngarkohet Drejtorja e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR**  
**Saimir TOLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Mimoza KAÇI**